

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“HADAR TRAINING ” SH.P.K

Sot, më datë 11/11/2022 (dy mije e njezet e dy), **Znj.Alessandra Scalera** , shtetase Italiane, i datëlindjes 14/01/1980, lindur në Mesagne (BR), dhe banues në Itali ,Mesagne (BR) rruga Guglielmo Marconi 186 – CAP 72023 , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit CA14778DM Vendosa te themeloje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1
Themelimi

Emri i shoqerise eshte” HADAR TRAINING **Sh.P.K.** Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri ”HADAR TRAINING **SH.P.K.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte Trajnime dhe Zhvillimi web software aplikacione dhe cdo gje qe ka lidhje me zhvillimet informatike ..

NENI 3
Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin ” **HADAR TRAINING ” SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është: Kompania synon të kryejë kurse trajnimi, master, seminare, uebinarë, transmetime në internet dhe çdo formë tjetër përhapjeje në fushën teknologjike, teknologjive të informacionit, fusha të tjera të lidhura si Inxhinieri Sistemesh, Rrjeta Kompjuterike, Administrim Serverash, Siguri Kibernetike, Virtualizim dhe Kontejnerë, Open Source, IoT, Cloud Computing, Big Data, Inteligjenca Artificiale, Gjuhët e Programimit, Baza e të Dhënave, DevOps dhe Blockchain. Ofrimi i trajnimeve mund të kryhet personalisht, drejtpërdrejt në distancë ose përmes krijimit të produkteve trajnuese për përdorim në vetë-studim që përdorin teknologjitë më të fundit dhe metodologjitë edukative si realiteti virtual dhe platformat elektronike te e-learning etj. .

Kompania propozon gjithashtu lëshimin e certifikatave zyrtare të përpunuara drejtpërdrejt ose për llogari të shumëkombësheve të ndryshme nëpërmjet aktivizimit të sistemeve të provimeve në vend dhe online, duke ofruar sisteme për verifikimin e aftësive të stafit të përfshirë në projekte trajnimi.

Këto ndërhyrje trajnimi mund t'u drejtohen individëve, punonjësve, kompanive për çdo grupmoshë si dhe të gjithë komunitet që ka nevojë për trajnime në fushën teknologjike. Shoqëria mund të realizojë projekte trajnimi për individë, organizata, shoqata, kompani, administrata publike në ambientet e tyre ose nga shtëpia; kurse trajnimi edhe nëpërmjet internetit dhe/ose organizimi dhe promovimi, edhe pa fitimprurje, i konferencave,

seminareve dhe takimeve në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat kanë si temë njohjen e teknologjive të informacionit dhe çështjeve të lidhura me to.
.Cdo operacion të ngjashëm dhe të lejuar nga legjislacioni privat

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në bashkinë Tirane, Adresa Tirane njesia nr 7 rruga Nikolla Lena ish Markata e vjeter kati I pare nr 9. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (një qind mijë) lek, Ortaku themelues znj. Alessandra Scalera të Shoqërisë Tregtare “HADAR TRAINING ” **SH.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:- **Z.Alessandra Scalera**, shtetas Italiane, i datëlindjes 14/01/1980 lindur në Mesagne (BR), dhe banues në Itali rruga Guglielmo Marconi 186-CAP 72023 mbajtës i kartes se identitetit me id CA14778DM zotërues i kuotave 100 % të përbërë nga 100.000(njëqind mijë) lek, duke përfaqësuar 100 %, të kapitalit **Znj Alessandra Scalera**, Kapitali themelues është shlyer plotësisht në para nga Ortaket me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themelues

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë **Z.Enea Gjini** shtetas shqiptar i datëlindjes 21/12/1997 lindur në (Tirane), dhe banues në Tirane, Rruga Besa nr 27 i mbajtes i kartes se identitetit me ID J60704076P shtetas Shqiptar,

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Alessandra Scalera

